



Nr (240)- 00003 Regj.Them
Data e regj. 05.01.2016

Nr 179-(82) Vendimi
Data 04.03.2016

VENDIM
"Ne emer te Republikes"

Gjykata administrative e shkalles se se pare Korçe e perbere prej:

Kryetare e seances gjyqesore - **ETLEVA GJAMO**

asistuar nga sekretare e seances gjyqesore Safjola Sadik ne Gjykate, ne date 04.03.2016 ora 15 00, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura çeshtjen administrative me nr (240)-00003 rregjistri themeltar , date 05.01.2016 rregjistrimi qe i perket:

PADITES: Shoqeria "ALBMIR" sh.p.k, me seli ne Korçe, ne adresen "Tregu ushqimor", e perfaqesuar me autorizim nga av Ermir Skenderi i Dhomes se Avokatise Korçe.

E PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe, perfaqesuar me autorizim nga juriste Mirela Veriga .

OBJEKTI: Shfuqizim "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" nr 6210 prot date 25.07.2012 ai akt absolutisht i pvalefshem.

BAZA LIGJORE: Kodi i procedurave Administrative , neni 116/c, neni 17/a i ligjit 49/2012, ligji 10279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative", neni 37 i ligjit 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", ligji 49/2012.

Ne perfundim te gjykimit te zhvilluar ne prani te perfaqesuesit me autorizim te paditesit dhe perfaqesueses me autorizim te pales se paditur, paditesi kerkoi pranimin e padise, perfaqesuesja e pales se paditur kerkoi rezimin e padise.
Gjykata pasi shqyrtoi aktet dhe çeshtjen ne teresi.

VEREN

Nga aktet bashkangjitur kerkese padise e referuar te dhenave te "Ekstraktit te rregjisitrit tregetar" ka rezultuar se shoqeria "ALBMIR" sh.p.k ushtron aktivitet tregetar ne qytetin e Korçes me objekt te veprimtarise "Prodhim, ambalazhim te produkteve ushqimore, tregetim karburante etj" ne adresen "Pazari Korçe" me NIPT K K04005028G.

Ne daten 17.07.2012 nga Inspektoret e Sektorit te verifikimit ne teren prane Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe eshte ushtraur kontroll ne ambientin e tij te ushtrimit te

aktivitetit ne Rugen Korçe-Maliq Km i I-rë dhe është mbajtur "Akti konstatimi" ku është evidentuar fakti se:

- ne pune e gjenden tre punonjes te cilet nuk pranian te identifikohe.
- subjekti është i pajisur me kase fiskale.
- ne momentin e ushtrimit te kontrollit subjekti nuk pret kuponin tatimor nga pajisja fiskale.

Ne kete akt konstatimi është pasqyruar fakti se është refuzuar te firmoset nga perfaqesuesi i tatimpaguesit.

Mbi te dhenat e aktit te konstatimit, po ne daten 17.07.2012 është mbajtur "Procesverbal gjobe" nga Inspektoret e DRT Korçe dhe ne baze te nenit 122, pika 1, germa b/i e ligjit nr 9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", subjekti është denuar me gjobe ne masen 200 000 leke, per shkak se ne momentin e kontrollit nuk pret kupon tatimor nga pajisja fiskale.

Ne daten 25.07.2014 Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka nxjere "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" me nr 6210 Prot ku subjektit i kerkohet pagesa e gjobes prrej 200 000 leke.

Ne daten 28.12.2015 paditesi paraqet padi ne Gjykaten Administrative te shkalles se pare Korçe me te cilen kerkon konstatimin e pavlefshmerise absolute te Njoftim vleresimit per detyrimet tatimore nr 6210 date 25.07.2015 pasi ai nuk është njoftuar asnjehere ne adrese te shoqerise por është vene ne dijeni ne daten 01.09.2015, pas komunikimit te Inspektoreve te borxhit tatimor per marjen e formulareve per disa gjoba te tjera me vlere te vogla. Pas komunikimit me punonjesit e DRT paditesi është pajisur me aktin e konstatimit dhe procesverbalin e gjobes dhe është vene ne dijeni se gjoba te jete vendosur per mosleshim te kuponit tatimor.

Pala e paditur ka shkelur ligjin nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" pasi Njoftim vleresimi duhet te dergohej ne adrese te subjektit me poste rekomande gje qe nuk ka ndodhur pasi ne adrese te subjektit nuk ka mberitur njoftim vleresimi pasi subjekti do te kishte ndjekur rrugen ligjore te ankimit administrativ.

Si akti i konstatimit ashtu edhe procesverbali i gjobes nuk jane mbajtur ne ambientet e subjektit por ne ambientet e DRT Korçe duke i mohuar subjektit te drejten per tu degjuar nga administrata tatimore sipas nenit 32 te ligjit 9920 date 19.05.2008 .

Ne kushtet kur është shkelur procedura lidhur me identifikimin e perfaqesuesit te subjektit ne mbajtjen e aktit te konstatimit dhe njoftimin e tij subjektit, duhet te konstatohet pavlefshmeria absolute e njoftim vleresimit si akt i nxjere ne kundershtrim me proceduren e parashikuar nga ligji.

Perfaqesuesja e pales se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe gjate gjykimit prapesoi se ne momentin e ushtrimit te kontrollit tatimor gjendja e konstatuar u pasqyrua ne procesverbal per mosprerje te kuponit tatimor per sherbimin e ofruar.

Ne baze te nenit 80.3 te ligjit 9920 date 19.05.2008 Inspektoret e verifikimit ne teren kryejne verifikime ne vendin e ushtrimit te aktivitetit me qellim zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje me veprimtarine e tatimpaguesit dhe akti i konstatimit është mbajtur ne zbatim korekt te ligjit 9920 date 19.05.2008 si dhe ligjit nr 10 279 date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative".

Paditesi kundershton njoftim vleresimin me pretendimin se nuk ka qene prezent ne momentin e kontrollit dhe nuk ka mare dijeni per njoftim vleresimin tatimor por keto

pretendime nuk qendrojnë pasi akti ka dalë pas një procedure të rregullt kontrolli të kryer mbi bazën e urdherit të punës, akti i konstatimit dhe procesverbali i gjës janë mbajtur në momentin e konstatimit dhe vendin e konstatimit, në përputhje me nenin 14 të ligjit 10 279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

Gjës është vendosur në vend dhe në zbatim të ligjit për procedurat tatimore dhe aktet e mbajtura i janë vene në dispozicionin personit të gjëndur në punë në momentin e kontrollit dhe pretendimi për mosnjohje të gjës është i pabazuar.

Tatimpaguesi ka shkelur një normë ligjore dhe shkelja është e dukshme pasi nga Inspektoret e DRT u konstatua kundravajtja administrative brenda ambienteve të aktivitetit dhe në kushtet kur nuk ka shkelje flagrante të ligjit që do të sillnin nulitet të aktit, padia e paditesit duhet të rezohet.

Gjykata pasi shqyrtoi pretendimet e paditesit, prapësimet e pales së paditur si dhe provat e sjellë prej tyre, bazuar edhe në përcaktimet e nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile në lidhje edhe me nenin 17/2 të ligjit 49/2012 çmon se padia e paditesit është e bazuar në ligj dhe në provë dhe si e tillë duhet të pranohet.

Në rastin konkret gjykata çmon se konflikti i parashtruar për zgjidhje rrjedh nga një procedim administrativ dhe për efekt të verifikimit të bazueshmerisë ligjore të pretendimeve të paditesit, përveç ligjit të posaçëm nr 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar) ku gjën rregullim ligjor shkelja që i atribuohet paditesit, do të referojë edhe në dispozitat e ligjit nr 10 279, datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative" si dhe nenin 116 të Kodit të procedurave Administrative që i referohet rasteve të pavlefshmerisë absolute të akteve administrative.

Lidhur me pavlefshmerinë absolute pala paditese pretendon se njoftim vlerësimi në vetvete përmban të shprehur njerin nga rastet për të cilin sipas nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative një akt administrativ konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm, përkatësisht mosrespektimin e formës dhe procedurës së parashikuar nga ligji.

Në këtë aspekt për efekt të çmuarjes së bazueshmerisë ligjore të pretendimeve të pales paditese gjykata do të marrë në analizë pretendimin për pavlefshmerinë absolute në raport me rrethanat faktike të çështjes objekt gjykimi.

Në kuptim të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative, aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme në rastet e mëposhtme:

- a) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar.
- b) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore.
- c) Kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kundërshtim me formën dhe procedurën e parashikuar nga ligji.

Në kuptim të pikës c) të këtij neni respektimi i formës dhe procedurës është një ndër elementet që përcakton vlefshmerinë e një akti administrativ dhe shkelja e formës dhe procedurës mund të kryhet në formë të ndryshme gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, por në kuptim të kësaj pike të dispozitës që të pasjellë në mënyrë të detyrueshme pavlefshmerinë absolute të një akti, kjo shkelje duhet të jetë e atij karakteri dhe e asaj rëndësie, sa që të ketë ndikuar drejtperdrejt në nxjerrjen e aktit. Pra në interpretim të sa më sipër, që shkelja e formës dhe procedurës të sjellë pavlefshmerinë e aktit duhet që ajo të

jete shkelje thelbesore e ligjit ose shkelje flagrante e tij, pasi shkalla e shkeljes se ligjit eshte dhe kriteri dallues mes pavlefshmerise relative dhe absolute te nje akti administrativ.

Ne ligjin per "Kundravajtjet administrative" nr 10279 date 20.05.2010, ne nenet 13-19 te tij, gjejne rregullim dhe procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit te kundravajtjes administrative, nder te tjera mbajtja e procesverbalit te konstatimit apo e nje dokumenti te barazvlefshem me te ne rastet kur konstatimi i shkeljes eshte i lidhur me vendin ku ndodh ngjarja pasi ne kete rast procesverbali i konstatimit ne teresine e tij eshte akti mbi te cilin organi qe shqyrton kundravajtjen administrative mer vendim.

Po ti referohemi "Aktit te konstatimit", nder te tjera permbahet i shprehur fakti se ne momentin e kontrollit ne pune e gjenden tre punonjes te cilet nuk pranuane te identifikohen, subjekti eshte i pajisur me kase fiskale, ne momentin e ushtrimit te kontrollit subjekti nuk pret kuponin tatimor nga pajisja fiskale dhe mandej mbi bazen ketij akti konstatimi, nga Inspektoret e DRT Korçe eshte konkluduar se tatimpaguesi ka shkelur nenin 122, pika 1, germa b(i) te ligjit nr 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" dhe per kete arsye ne cilesine e personit juridik duhet te ndeshkohet me gjobe prej 200 000 leke.

Nga formulimi i kesaj dispozite te ligjit te posaçem, çdo tatimpagues ka detyrimin ligjor per prere kupton tatimor per sherbim te realizuar pasi ne rast te kundert ndeshkohet me gjobe.

Ne kuptim te nenit 80.3.c te Udhzimit nr 24 date 02.09.2009 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" njihet e drejta e Inspektoreve te verifikimit ne teren per te kryer kontrole te llojit "Verifikime ne vend" te cilat synojne zbulimin ne kohe te shkeljeve qe kane lidhje nder te tjera edhe me perdorimin e pajisjeve fiskale ndersa ne parag e fundit te pikes 80.3 parashikohet se ...procedurat teknike te detajuara per kryerjen e kontrollit tatimor percaktohen ne manualin e kontrollit tatimor.

Ne piken 6 te ketij manuali qe i referohet procedurave qe ndiqen per kryerjen e verifikimeve nga sektori i verifikimit ne teren, parashikohet se :

• Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, për shkeljet e vërtetuara, kanë për detyrë t'ja komunikojnë tatimpaguesit, t'ia bëjnë të qartë atij shkeljen e konstatuar duke ju referuar aktin ligjor apo nënligjor dhe më pas të dokumentojnë rezultatet e punës së çdo verifikimi të kryer ne proces-verbal, akt-verifikimi etj, sipas modeleve bashkengjitur manualit. Për çdo verifikim, pavarësisht se vërtetohet ose jo shkelje, rezultati dokumentohet me akt konstatimi dhe, për çdo shkelje të vërtetuar mbahet proces-verbal sipas modelit bashkengjitur. Një kopje e proces-verbalit apo akt konstatimit i lihet subjektit.

Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e dispozitave ligjore qe lidhen me pajisjet fiskale ne kete manual peraktohet se ..kur pajisja fiskale eshte e instaluar verifikohet nese leshohet kupon tatimor per çdo shitje te kryer.

Subjekti pretendon se nga grupi i inspektoreve ne momentin e kontrollit nuk eshte mbajtur akt konstatimi dhe nuk i eshte dorezuar asnje akt konstatimi dhe ne perfundim te tij pala e paditur nuk arriti te provoje para gjykates se ne mbajtjen e aktit te konstatimit eshte respektuar forma dhe procedurat detyruese te parashikuara ne ligj per mbajtjen e aktit te konstatimit dhe ariti te provoje se nje kopje e aktit i ehste lene ne vend subjektit pasi nje rrethane e tille nuk gjen pasqyrim ne permbajtje te aktit te konstatimit.

Pra Inspektoret e verifikimit ne teren ne shkelje te detyrave te tyre funksionale duke mos zbatuar dispozitat detyruese dhe duke mos i komunikuar personit me te cilin pretendojne se kane kontaktuar nje kopje te tij, i kane hequr mundesine per tu degjuar dhe per te dhene sqarime lidhur me shkeljet e pasqyrura nga grupi i inspektoreve ne kete aspekt "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" ka dale mbi bazen e rezultateve te nje "Akti konstatimi" te mbajtur ne kundershtrim me formen dhe proceduren e parashikuar nga ligji dhe rjedhimisht mbi bazen e nje akti absolutisht te pavlefshem, rezultatet e te cilit nuk mund te sjellin asnje pasoje juridike dhe te perbejne baze per penalizimin e subjektit.

Pala e paditur ngriti pretendimin se ne momentin e kontrollit tatimpaguesi nuk priste kupon tatimor per sherbimin e ofruar por te dhenat e evidentuara ne momentin e kontrollit, nuk permbajne elementet e domosdoshem dhe te mjaftueshem qe provojne se ndodhemi para nje kundravajtje administrative ne fushen tatimore pasi nuk gjen pasqyrim fakti qe te jete kryer shitje nga subjekti ne momentin e kontrollit siq percaktohet ne manualin e verifikimit ne teren qe i referohet veprimeve te inspektorit ne rastet e kontrollit te zbatimit te legjislacionit qe lidhet me perdorimin e pajisjeve fiskale.

Kjo per faktin se qe te kemi kundravajtje administrative ne kuptim te nenit 4 te ligjit nr 10 279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative", duhet qe *te jete kryer shkelja me faj e dispozitave ligjore dhe nenligjore, te kryera me veprim ose mosveprim dhe per te cilat ligji parashikon denim administrativ.*

Ne rastin konkret nga te dhenat e aktit te konstatimit i cili eshte pikenisja e penalizimit te tatimpaguesit, nuk provohet se ai ka shkelur me faj dispozitat ligjore me mosveprim, pasi nuk provohet se ai ka shkelur nenin 122, pika 1 germa b) te ligjit "Per procedurat tatimore", pra nuk vertetohet shkelja e atribuar.

Ne analize te sa me siper cmohet pranimi i padise, duke u konstatuar pavlefshmeria absolute e aktit administrativ, "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" pa regulluar pasoja pasi subjekti nuk rezlton qe te kete paguar detyrimin tatimor gjobe.

Ne veshtrim te nenit 45 germa a) te ligjit 49/2012 ky vendim eshte i paankimueshem pasi sipas kesaj dispozite.... *nuk lejohet ankim ndaj vendimeve perfundimtare te gjykates administrative per padi me objekt kundershtrimin e denimit per kryerjen e kundravajtjeve administrative me vlere me te vogel se 20-fishi i pages minimale ne shkalle vendi.* Ne baze te VKM nr. 573, date 3.7.2013, "Per percaktimin e pages minimale ne shkalle vendi", duke filluar nga muaji Korrik 2013 e ne vazhdim, paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, eshte 22.000 (njezet e dy mije) leke.

Lidhur me shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3 000 leke te parapaguara nga pala paditese, konform nenit 106/1 te K.Pr.C i ngarkohen pales se paditur, meqenese cmohet pranimi i padise.

PER KETO ARESYE

Gjykata bazuar ne nenin 40-43 dhe 45, a) te ligjit 49/2012 si dhe 116 te Kodit te Procedurave Administrative

VENDOSA

1. Pranimin e padise se paditesit "ALBMIR" sh.p.k, pale e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe duke u konstatuar pavlefshmeria absolute e "Njoftim vleresimit per detyrimet tatimore nr 6210 prot date 25.07.2012" te DRT Korçe per detyrimet tatimore gjobe ne masen 200 000, leke si akt i nxjere ne kundershtim me proceduren e parashikuar nga ligji.

2. Shpenzimet gjyqesore te takses mbi aktet ne shumen 3000 leke i ngarkohen pales se paditur.

3. Ky vendim eshte perfundimtar dhe kunder tij nuk lejohet ankim.

U shpall ne Korçe date 04.03.2016

Sekretare
Safjola Sadik



GJYQTARE
ETLEVA GJAMO

